

Republika e Kosovës
Gjykata Themelore e Ferizajt

Nr.Prot: 20433/1

Data: 16.07.2025

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

ndërmjet

Gjykatës Themelore në Ferizaj

dhe

UNI-Universum International College

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është themelimi i bashkëpunimit në mes të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe UNI-Universum International College (më tutje UNI), i cili do t'u mundësonte studentëve të Departamentit Juridik, të Shkollës për Studime Globale të UNI-të mbajtjen e praktikës gjyqësore, që do të përfshinte edhe pjesëmarrje në shqyrtime gjyqësore, vizita studimore në gjykata, bashkëpunim për praktikë simuluese gjyqësore. Ky memorandum krijon mundësitë edhe për organizimin e tryezave të ndryshme në mes të dy institucioneve.

Neni 2

Obligimet e UNI-të

- 2.1 Sigurohet se puna praktike e studentëve në Gjykata vlerësohet dhe konsiderohet si pjesë shtesë e mësimit teorik të studentëve.
- 2.2 Sipas pëlqimit të Gjykatës, siguron numrin e studentëve që do të mbajnë praktikën.

- 2.3 Përgatit dhe të mirëmban regjistrin me emrat e studentëve dhe kohën në të cilën ata do ta kryejnë praktikën në gjykata si dhe ia dërgon gjykatës listën e praktikantëve një javë para fillimit të mbajtjes së praktikës.

Neni 3

Obligimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj

- 3.1 Në koordinim me UNI-në u mundëson studentëve të tij mbajtjen e praktikës për periudhën kohore të përcaktuar nga Gjykata.
- 3.2 Njofton UNI-në, me kohë, për numrin e studentëve që mund të kryejnë praktikën në Gjykata sipas kritereve të caktuara.
- 3.3 Njofton UNI-në për kohën dhe vendin e mbajtjes së praktikës së studentëve, si dhe pas përfundimit me sukses të praktikës sipas mundësisë pajis studentët me një dëshmi përkatëse.

Neni 4

Bashkëpunimi profesional

- 4.1 Palët pajtohen të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtim të rritjes së cilësisë së programit të trajnimit praktik për studentët.
- 4.2 Studentëve dhe profesorëve në marrëveshje me gjykatën do t'u mundësohen vizitat studimore. Po ashtu gjykata mund të ndihmojë UNI-në organizimin e praktikës simuluese gjyqësore.
- 4.3 Për implementimin e konferencave, debateve, simpoziumeve, UNI i vë në dispozicion Gjykatës Themelore të Ferizajt, por edhe vetë Këshillit Gjyqësor pa kompensim klasat dhe ambientet e tjera; kufizim i vetëm për këtë dispozitë është orari i rregullt i mësimit të studentëve të UNI-të.
- 4.4 UNI ofron qasje në bibliotekën e kolegjit si dhe sipas nevojës dhe kërkesës edhe përkrahje profesionale nga Departamenti Juridik.

Neni 5

Kohëzgjatja e Memorandumit

- 5.1 Palët mund të modifikojnë segmente të caktuara të bashkëpunimit me pajtim të ndërsjellë nëpërmjet letrës përcjellëse për vazhdimin e bashkëpunimit.


- 5.2 Memorandumi i mirëkuptimit nënshkruhet për periudhën 3 (tri) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
- 5.3 Marrëveshja mund të përfundohej nga secila palë me një paralajmërim me shkrim së paku tre muaj para ndërprerjes së njëanshme.
- 5.4 Pala mund të japë arsyet e ndërprerjes së bashkëpunimit në shkresën e paralajmërimit.
- 5.5 Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje në gjuhën shqipe. Të dyja palët mbajnë nga një kopje të marrëveshjes në origjinal.
- 5.6 Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Në pajtim të plotë, palët e nënshkruajnë këtë Memorandum të bashkëpunimit me datë



UNI-Universum International College

Valon Murati,

Zëvendës President për Marrëdhënie me Jashtë
dhe Bashkëpunim me Komunitetin

Ferizaj, 16.07.2025



Gjykata Themelore e Ferizajt

Mustaf Tahiri,

Kryetar